ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PUBLIK

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

ANKESË

Për: Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik

Kundër: Ministrisë së Punëve të Brendshme

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr. i Prokurimit	**214-21-6523-1-2-1**
Nr. i brendshëm	**214-21-063-121**

Sa i përket tenderit për:

Furnizim me material shpenzues ani Covid për stafin e MPB-se

1. **Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK**

"Ardi" sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr. "Nëna Terezë" nr. 187.

(Adresa)
Fushë Kosovë
(Vendi)

12000
(Kodi postar)

049888866
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Fadil Demiri
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ardishpk@hotmail.com
(Adresa elektronike)

SH.P.K. ARDI NRF: 600119186 FUSHË KOSOVË

28.07.2023
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____

_____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. ARDI NRF: 600119186 FUSHË KOSOVË

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Me datën 30.09.2021 është publikuar B05 njoftimi për kontratë.
- Me datën12.11.2021 kemi pranuar letrën standarde për tenderuesin e eliminuar;
- Më datë 12.11.2021 është publikuar Njoftimi për dhënie të kontratës;
- Kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulte.
- Më datë 14.07.2023 është publikuar Njoftimi mbi anulimin e aktiviteti te prokurimit;
- Më datë 25.07.2023 është publikuar Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

- Me datën 11.10.2021 Autoriteti Kontraktues ka publikuar në platformë procesverbalin e hapjes së ofertave.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi i Ligjit për Prokurimin Publik
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP-së
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

SH.P.K. ARDI NRF: 600119186 FUSHË KOSOVË

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 62
Neni 44 pika 5 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik,

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Më datë 14.07.2023, Autoriteti Kontraktues MPB ka marrë Vendim – Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit me numër 214-21-6523-1-2-1 me titull "Furnizim me material shpenzues anti Covid për stafin e MPB-së", me arsyetim se ky aktivitet i prokurimit për shkak të ankesave në OSHP, nuk ka përfunduar dhe për këtë arsye AK thekson se ka kërkuar nga Njësia kërkuese e inicimit dhe se kanë marrë përgjigje se nuk ka nevojë për këtë furnizim dhe nuk ka mjete buxhetore të ndara në vitin 2023 dhe vitin e ardhshëm për këtë furnizim. Kështu, AK konstaton se duke u mbështetur në arsyetimin nga Njësia kërkuese, bazuar edhe në vendimin ku Qeveria e Kosovës më datë 24.05.2023 ka shpallur të përfunduar zyrtarisht pandeminë COVID 19 me të cilin është miratuar edhe largimi i të gjitha masave anti – covid 19, MPB ka marrë vendim për anulimin të këtij aktiviteti të prokurimit.

Kundër këtij njoftimi dhe vendimi OE "Ardi" sh.p.k., ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim pranë AK, ku kjo e fundit duke vepruar sipas ankesës më datë 25.07.2023 ka marrë vendim (pa numër të referencës) me të cilin ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE "Ardi" sh.p.k.

PROVË: Vendimi i AK MPB i datës 25.07.2023.

OE "Ardi" sh.p.k., konsideron se njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit i datës 14.07.2023 dhe vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i datës 25.07.2023, janë në tërësi të kundërligjshëm për arsyet si në vijim:

1. Si fillim, siç jeni në dijeni të nderuar anëtar të OSHP-së, AK MPB e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit edhe një herë tjetër më parë dhe atë më datë 24.01.2023. Kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe kundër vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, OE "Ardi" sh.p.k., ka parashtruar ankesën në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik, ku kjo e fundit ka marrë vendim nr. prot 023/0071, me të cilin ka aprovuar ankesën e OE "Ardi" sh.p.k., dhe ka anuluar njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit në fjalë dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim te AK MPB. Andaj kjo çështje përbën "Res Judicata/Çështje të gjykuar".

SH.P.K. ARDI NRF: 600119186 FUSHË KOSOVË

PROVË: Vendimi i OSHP nr. 2023/0071 i datës 25.04.2023.

2. Me këtë vendim OSHP ka konstatuar qartë se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ekziston një vendim i Gjykatës me numër KA.nr.1327/22 i datës 14.11.2022 me të cilin është shtyer ekzekutimi i vendimit të OSHP-së me numër PSH.nr.53/2022 me të cilin ishte hedhur poshtë si e jashtë afatit për shqyrtim ankesa e OE "Ardi" sh.p.k., e parashtruar në OSHP. Kështu, sipas OSHP dhe ekspertit shqyrtues, nuk mund të merret një vendim tjetër për këtë aktivitet të prokurimit përderisa ekziston vendimi i Gjykatës Komerciale me numër KA.nr. 1327/22 i datës 14.11.2022.

PROVË: Aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë – Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1327/22 të datës 14.11.2022.

3. Po ashtu, eksperti shqyrtues ka konstatuar se anulimi i aktivitetit të prokurimit në këtë fazë të prokurimit bije ndesh me me dispozitën e nenit 62 të Ligjit për Prokurimin Publik, ku përcaktohet se përfundimi i aktivitetit të prokurimit bëhet për arsyet si më poshtë:

"Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një shkeljeje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. 2.Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 2.1. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo 2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve."

4. Siç mund të shihni AK MPB edhe me anulimin e aktivitetit të prokurimit përmes njoftimit të datës 14.07.2023 dhe më pas me vendimin e datës 25.07.2023 për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, ka shkelur këtë dispozitë ligjore sepse arsyet e dhëna nga AK MPB nuk hyn në kuadër të dispozitës së nenit 62 të LPP-së.

5. AK MPB ka theksuar se ka arsye objektive për të anuluar këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo siç mund të shihni nga neni 62 paragrafi 2.2 i Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-042 kërkon që kjo arsye e eliminimit për arsye objektive mund të ndodhë vetëm nëse anulimi bëhet 3 ditë para hapjes së tenderëve, e që në rastin konkret hapja e tenderëve është bërë muaj më parë.

SH.P.K. ARDI NRF: 600119186 FUSHË KOSOVË

6. Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit bije ndesh dhe shkel edhe dispozitën e nenit 44 pika 5 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, ku përcaktohet se:

"44.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: (i) asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; (ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; (iii)numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE - është më pak se 3; (iv)nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; (v) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3; (vi)nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; (vii) asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; (viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; (ix)një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; (x) nëse AK gjate përgaditjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i paripërueshëm; ose (xi)nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i paripërueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP."

7. Siç mund të shihet arsyet që AK MPB ka specifikuar për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit bijën ndesh me dispozitën e lartcekur dhe këto konstatime OSHP i ka dhënë me vendimin e lartcekur, mirëpo si duket AK MPB ka vendosur të injoroj në tërësi vërejtjet e dhëna nga OSHP.

8. Rrjedhimisht, duke qenë se ekziston një vendim gjyqësor që ka shtyr ekzekutimin e vendimit të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit PSH.nr.53/2022, AK Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka të drejtë të anuloj këtë aktivitet të prokurimit. Andaj, luteni që këtë vendim gjyqësor ta respektoni sepse mos respektimi i tij përbën VEPËR PENALE. Më tutje, AK ka theksuar se një dispozitë e Ligjit e kërkon anulimin. Mirëpo, nuk ka cekur asnjë dispozitë ligjore se në bazë të cili ligj e anulon këtë aktivitet të prokurimit.

9. AK arsyeton se deri te vendimi për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit ka ardhur pas vendimit të Qeverisë së Kosvës me numër 05/143 të datës 24.05.2023 ku AK pretendon se kinse me këtë vendim është shpallur e përfundurar zyrtarisht pandemia me covid 19. Ky konstatim i AK MPB përëbën keqinterpretim apo thënë më mirë tendencë për të vënë në lajthim Operatorët Ekonomik, sepse nuk është e vërtetë se me vendimin e Qeverisë së Kosovës 05/143 të datës 24.05.2023, është shpallur e përfunduar pandemia covid19. Nëse lexohet ky vendim me të njëjtin është shpallur e mbyllur Emergjenca në shendetin publik, respektivisht gjendja emergjente e shpallur me vendimin e mëparshëm të Qeverisë 01/11 të vitit 2020, mirëpo nuk është shapllur e përfunduar pandemia me covid 19, sepse sic jeni në dijeni, përfundimin e pandemisë mund ta bëj

SH.P.K. ARDI NRF: 600119186 FUSHË KOSOVË

vetëm Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe ne nuk jemi në dijeni të një vendimi të tillë të OSHB-së. Me vendimin e Qeverisë nr. 05/143 pika II e vendimit është obliguar Ministria e Shëndetësisë që të përcjellë situatën epideomologjike në vend dhe të marrë masa konform gjendjes, e që nënkupton se situata epideomologjike me covid 19 ende ekziston dhe nuk ka përfundim të pandemisë ende.

PROVË: Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 05/143 të datës 24.05.2023.

10. Andaj, arsyetimi se nuk ka nevojë për këtë aktivitet të prokurimit është i paqëndrueshëm dhe po ashtu është i paqëndrueshëm arsyetimi se kinse Qeveria e paska shpallur të përfunduar padneminë me covid19 në Kosovë.

11. Më tutje, AK MBP e ka mbështetur arsyetimin e anulimit të vendimit në nenin 62 paragrafi 1.1, mirëpo nuk arsyeton fare se cila shkelje e ligjit ka ndodhur apo do të ndodhte në vijim, andaj ky anulim i pësëritur i këtij aktiviteti të prokurimi nga ana e AK bije ndesh me dispozitat e lartcekur dhe me vendimin e mëparshëm të OSHP-së.

12. Po ashtu, konsiderojmë se kjo çështje përbën çështje të gjykuar/res judicata sepse OSHP ka vendosur që ky aktivitet i prokurimit nuk mund të anulohet dhe ka urdhëruar AK MPB të marrë veprime për përfundim me sukses të këtij aktiviteti të prokurimti, andaj i propozojmë OSHP-së që ta trajtoj edhe këtë pretendim me kujdes të shtuar.

13. Keni parasysh se me këtë vendim AK MPB na dëmtuar financiarisht sepse ne si OE kemi pasur shpenzime për përgatitje të dosjes së tenderit dhe po ashtu kemi blerë mallin i cili duhet të liferohet sipas kësaj kontrate andaj për këto kërkojmë kompensim nga ana e AK MPB.

14. Si përfundim, OE "Ardi" sh.p.k., i propozon Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, që në prani të këtyre argumenteve dhe provave të bashkangjitura të marrë këtë:

VENDIM

APROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik "Ardi" sh.p.k., e parashtruar kundër vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të datës 25.07.2023 [pa numër referencë] dhe Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 14.07.2023 të Autoritetit Kontraktues Ministrisë së Punëve të Brendshmë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material shpenzues anti Covid për stafin e MPB" me numër të prokurimit 214-21-6523-1-2-1.

ANULOHEN në tërësi vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i datës 25.07.2023 [pa numër referencë] dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 14.07.2023 të marra nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material shpenzues anti Covid për stafin e MPB" me numër të prokurimit 214-21-6523-1-2-1 **ashtu që Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik merr VENDIM** me të cilin aktivitetin

SH.P.K. ARDI NRF: 600119186 FUSHË KOSOVË

e prokurimit me titull "Furnizim me material shpenzues anti Covid për stafin e MPB" me numër të prokurimit 214-21-6523-1-2-1, e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje te AK MPB ashtu që të vazhdoj me procedurat e prokurimit dhe të shpall OE "Ardi" sh.p.k., si fitues-tenderues të suksesshëm si OE i përgjegjshëm dhe me çmimin më të lirë.

Fushë Kosovë, 28.07.2023

Operatori Ekonomik:

"Ardi" sh.p.k.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e supozuara kanë shkaktuar dëmtim të imazhit të kompanisë kur merret parasysh afarizmi jonë në tregun global. Gjithashtu na është shkaktuar dëm material-financiar dhe po ashtu fitim i humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

SH.P.K. ARDI NRF: 600119186 FUSHË KOSOVË